

PAULO COELHO
SHTRIGA E PORTOBELOS
ROMAN

BOTIMET TOENA

Libra nga Paulo Coelho,
prej Shtëpisë Botuese TOENA

- Alkimisti
- Mali i pestë
- Veronika vendos të vdesë
- Djalli dhe zonjusha Prym
- Njëmbëdhjetë minuta
- Pelegrini i Kompostelës
- Manuali i luftëtarit të dritës
- Zahiri

Paulo COELHO

Shtriga e Portobelos

■ *roman* ■

Përktheu:
Edlira HOXHOLLI

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2007

Titulli në original

Paulo Coelho, A bruxa de Portobello

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me
Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L., Barcelona.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botues: Fatmir Toçi

Redaktor: Bashkim Shehu

Përkujdesja grafike: Mereme Nelaj

Kopertina: Irena Toçi

ISBN 978 - 99943 - 1 - 255 - 9

© Paulo Coelho (www.paulocoelho.com)

© Në gjuhën shqipe: Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollësia", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117

E-mail: toena@toena.com.al; info@toena.com.al; toena@icc.al.eu.org

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Për S.F.X., diell që përhap dritë dhe ngrohtësi kudo
që kaloi, dhe shembull për ata që mendojnë përtej
horizonteve të tyre.*

*Oh, Marie, e ngjizur pa mëkatuar, lutu
për ne që përgjërohemi për Ty!
Amen.*

Askush nuk e ndez pishtarin për ta vënë në një vend të fshehtë, ose nën tokë, po për ta vënë mbi një shandan, që ta shohin shndritjen ata që hyjnë.

LUKA, 11,33

Para se këto dëshmi të largoheshin nga tryeza ime e punës e të ndiqnin rrjedhën që u kisha përcaktuar, mendoja t'i përfshija në një libër të zakonshëm, ku tregohet një histori e vërtetë mbas një kërkimi shterues.

Fillova të lexoja një sërë biografish që do të më ndihmonin për të shkruar dhe kuptova një gjë: opinioni i autorit lidhur me personazhin kryesor tekefundit ndikon në rezultatin e kërkimeve. Meqenëse qëllimi im nuk ishte të thosha ato që mendoja, por të tregoja se si e panë historinë e “shtrigës së Portobelos” personazhet kryesorë të librit, më në fund hoqa dorë nga ideja e tij; mendova se do të ishte më mirë të hidhja në letër thjesht ato që më kishin treguar.

Heron Rajan, 44 vjeç, gazetar

Askush nuk ndez një llambë që ta fshehë pas dere: qëllimi i dritës është që të japë më shumë dritë, që të t'i hapë sytë dhe të tregojë mrekullitë që ndodhen përreth.

Askush nuk e flijon gjënë më të vyer që ka:
dashurinë.

Askush nuk i lë ëndrrat e veta në duart e atyre
që mund t'i shkatërrojnë.

Përveç Athinës.

Shumë kohë pas vdekjes së saj, ish mësuesja e vet
më kërkoi ta shoqëroja në qytetin Prestonpans, në
Skoci. Aty, duke përfitur nga një ligj feudal që u
hoq një muaj më vonë, qyteti shpalli faljen publike
për tetëdhjetë e një persona - dhe macet e tyre - të
ekzekutuar si shtriganë gjatë shekujve XVI dhe XVII.

Sipas zëdhënësit zyrtar të Baronëve të
Prestaungrenxhit dhe të Dolfinstaunit, “më të
shumtët dënuar pa asnjë provë konkrete, duke u
bazuar vetëm te dëshmitarët e akuzës, që deklarorin
se kishin ndjerë praninë e shpirtave të këqij”.

Nuk ia vlen të kujtojmë edhe një herë të gjitha
krimet e Inkuizicionit, me rrotat e torturës dhe
turrat e druve ku flakëronte urrejtja dhe hakmarrja.
Mirëpo, gjatë rrugës, Eda përsëriti disa herë se
në këtë veprim kishte diçka që nuk mund ta
pranonte: qyteti dhe Baroni i katërmbëdhjetë
i Prestaungrenxhit dhe i Dolfinstaunit po u
“akordonin faljen” njerëzve të ekzekutuar egërsisht.

- Jemi në shekullin XXI dhe pasardhësit
e kriminelëve të vërtetë, të atyre që vranë të
pafajshmit, ende besojnë tek e drejta për “të falur”.
E kupton ku e kam fjalën, apo jo, Heron?

E kuptoja. Një gjueti e re shtrigash ka filluar të fitojë terren; këtë herë, arma nuk është hekuri i skuqur, po ironia dhe ndrydhja. Kushdo që zbulon se ka një dhunti, ose që rastësisht guxon të flasë për prirjen e vet, do të shihet me mosbesim. Prandaj, zakonisht, burri, gruaja, babai, djali apo kushdo qoftë, në vend që të krenohen me të, e ndalojnë madje edhe ta përmendë, nga frika se mos bëhen qesharakë.

Para se ta njihja Athinën, mendoja se ishte thjesht një mënyrë e pandershme për të zhbiruar dëshpërimin e qenies njerëzore. Edhe udhëtimi që bëra në Transilvani për dokumentarin mbi vampirët ishte një mënyrë për të treguar se sa lehtë mund t'i gënjesh njerëzit; disa besime vazhdojnë të ruhen në imagjinatën e qenies njerëzore, sado absurde që mund të duken, dhe më së fundi përdoren njerëz të paskrupull. Kur po vizitoja kështjellën e Drakulës, të rindërtuar thjesht për t'u krijuar turistëve ndenjën se ndodhen në një vend të veçantë, m'u afrua një zyrtar qeveritar; ma hodhi fjalën se do të merrja një dhuratë mjaft “domethënëse” (sipas fjalëve të tij) kur filmi t'i kalonte BBC-së. Sipas këtij zyrtari, unë po ndihmoja në përhapjen e rëndësisë së mitit dhe kjo meritonte të shpërblehej bujarisht. Një nga udhërrëfyesit tha se numri i vizitorëve rritej çdo vit dhe çfarëdo përmendje e vendit do të ishte pozitive, madje edhe ato që pohonin se kështjella

ishte e rreme, që Vlad Drakuli ishte një personazh historik pa asnjë lidhje me mitin dhe se gjithçka ishte fryt i delirit të një irlandezi (*Shënim i gazetarit: Bram Stoker*) që nuk e kishte shkelur kurrë në atë zonë.

Atëherë kuptova se, sado i saktë që të isha në faktet, pa dashje po merrja pjesë në thurjen e një gënjeshtre; ndonëse ideja e udhëtimit tim ishte pikërisht çmitizimi i vendit, njerëzit besojnë atë që duan; udhërrëfyesi kishte të drejtë, në fund të fundit po bashkëpunoja duke bërë më shumë propagandë. Menjëherë hoqa dorë nga projekti, ndonëse kisha shpenzuar një shumë të arsyeshme për udhëtimin e për hulumtimet.

Po udhëtimi në Transilvani do të linte një gjurmë të jashtëzakonshme në jetën time: njoha Athinën, ndërkohë që ajo kërkonte nënën e saj. Fati, fati misterioz e i pamëshirshëm, na vuri ballë për ballë në sportelin e rëndomtë të një hoteli edhe më të rëndomtë. Isha dëshmitar i bisedës së saj të parë me Deidren, ose Edën, siç i pëlqen ta quajnë. Si të isha spektator i vetes, u ndodha i pranishëm në luftën e kotë që po bënte zemra për të mos më lejuar të tundohesha nga një grua që nuk i përkiste botës time. U gëzova kur arsyeja e humbi betejën dhe alternativa e vetme që më mbeti ishte të dorëzohesha e të pranoja se isha dashuruar.

Ky pasion më bëri të shoh rituale që as e merrja me mend se ekzistonin, dy materializime, ose transe.

Duke besuar se isha verbuar nga dashuria, vura në dyshim çdo gjë, ndërsa dyshimi, në vend që të më paralizonte, më shtyu drejt oqeanesh që nuk mund ta pranoja se ekzistonin. Ishte kjo forcë që në çastet më të vështira ma bëri të mundur të përballoja cinizmin e miqve të mi gazetarë dhe të shkruaja për Athinën dhe punën e saj. E meqë dashuria është ende e gjallë, ndonëse Athina ka vdekur, kjo forcë vazhdon të jetë e pranishme, por nuk dua gjë tjetër veçse të harroj ato që pashë e që mësova. Në këtë botë mund të lëvizja vetëm i mbajtur për dore nga Athina.

Këto ishin kopshtet, lumenjtë dhe malet e saj. Tani që ajo ka ikur, dua që gjithçka të bëhet sa më shpejt siç ka qenë më parë; do t'u kushtoj më shumë vëmendje problemeve të trafikut, politikës së jashtme të Britanisë së Madhe, mënyrës se si administrohet paraja e nxjerrë nga taksat. Dua të kthehem përsëri te mendimi se bota e magjisë s'është veçse një truk i stisur mirë. Se njerëzit janë besëtytë. Se gjërat që shkenca nuk mund t'i shpjegojë s'kanë të drejtë të ekzistojnë.

Kur mbledhjet e Portobelos filluan të dalin nga kontrolli, pati debate pa fund lidhur me sjelljen e saj, ndonëse sot gëzohem që nuk më dëgjoi kurrë. Në qoftë se ekziston ndonjë farë ngushëllimi për fatkeqësinë e humbjes së dikujt që aq shumë e dashurojmë, është shpresa, gjithmonë e nevojshme, se ndoshta më mirë që ndodhi kështu.

Fle dhe zgjohem me këtë bindje; ishte më mirë që Athina iku përpara se të zbriste në ferrin e kësaj toke. Kurrë nuk do t'i kthehej paqja në shpirt mbas atyre ngjarjeve ku e paraqitën si “shtriga e Portobelos”. Jeta e saj do të ishte një përplasje e hidhur mes ëndrrave të veta dhe realitetit kolektiv. Duke ia njohur natyrën, e di që do të luftonte deri në fund, do të harxhonte krejt energjinë dhe gëzimin për të demonstruar diçka që askush, pa përjashtim askush, nuk është i gatshëm ta pranojë.

Ndoshta e kërkoi vdekjen si ai anijembyturi që kërkon një ishull. Do të ketë shkuar në shumë e shumë stacione metroje ndaj të gdhirë, duke pritur grabitës që nuk vinin. Ka ecur përmes lagjeve më të rrezikshme të Londrës në kërkim të një vrasësi që nuk shfaqej. Ka ngacmuar zemërimin e të fortëve, që nuk arritën ta shfaqnin tërbimin e tyre.

Derisa ia arriti që ta vrisnin çnjerëzisht. Por, në fund të fundit, sa prej nesh arrijmë t'i shmangemi pamjes se si zhduken sa hap e mbyll sytë gjërat më të rëndësishme të jetës sonë? Nuk e kam fjalën vetëm për njerëzit, po edhe për idealet e ëndrrat që kemi: mund të durojmë një ditë, një javë, disa vjet, por jemi të dënuar të humbim. Trupi vazhdon të jetojë, por, herët a vonë, shpirti merr një goditje vdekjeprurëse. Krim i përkryer, nuk e dimë kush na e vrau gëzimin, çfarë motivesh e shtynë, madje as edhe ku janë fajtorët.

E këta fajtorë, që nuk i thonë emrat, a janë të ndërgjegjshëm për veprimet e tyre? Nuk e besoj, sepse edhe ata janë viktima të realitetit që kanë krijuar, ndonëse janë depresivë, arrogantë, të pafuqishëm e të fuqishëm.

Nuk e kuptojnë dhe kurrë nuk do ta kuptonin botën e Athinës. Gjysma e së keqes që e them kështu: bota e Athinës. Më në fund, po pranoj ca nga ca që ajo ishte këtu kalimthi, diçka si favor, si dikush që gjendet në një pallat të bukur, duke ngrënë gjërat më të shijshme, i ndërgjegjshëm se nuk është gjë tjetër veçse një festë, se pallati nuk është i veti, se ushqimi nuk është blerë me paratë e tij, dhe se, në një moment të caktuar, dritat do të fikën, të zotët e shtëpisë do të shkojnë të flenë, punonjësit e shërbimit do të kthehen nëpër dhomat e tyre, dera mbyllet, dhe përsëri jemi në rrugë, duke pritur taksinë apo autobusin, për t'u kthyer te mediokriteti i jetës së përditshme.

Po kthehem. Thënë më saktë: një pjesë e imja po kthehet në këtë botë ku ka kuptim vetëm ajo që shohim, që prekim dhe që mund ta shpjegojmë. Dua përsëri gjobat për tejkalim shpejtësie, njerëzit që zihen në bankë, qaravitjet e përjetshme për motin, filmat me tmerre dhe garat Formula 1. Ai është universi ku do të më duhet të jetoj ditët që më kanë mbetur; do të martohem, do të kem fëmijë, ndërsa e kaluara do të jetë një kujtim i largët, që

në fund të fundit do të më bëjë të pyes veten gjatë ditës: Si munda të isha aq i verbër? Si munda të isha aq naiv?

Po ashtu, e di se gjatë natës një pjesë e imja do të endet në hapësirë, e lidhur me gjëra aq reale si paketa e cigares apo gota e xhinit që kam përpara. Shpirti im do të vallëzojë me shpirtin e Athinës, do të jem me të kur fle, do të zgjohem gjithë djersë, do të shkoj në kuzhinë të pi një gotë ujë, do të kuptoj se për të luftuar me fantazmat duhen përdorur armë që nuk janë pjesë e realitetit. Atëherë, duke ndjekur këshillat e gjyshes, do të vë një palë gërshërë të hapura mbi komodinë për të prerë vazhdimin e ëndrrës.

Në mëngjes do t'i shohë gërshërët me njëfarë brerje ndërgjegjeje. Po duhet t'i përshtatem sërishmi kësaj bote, se ndryshe do të çmendem.

Andrea Mekejn, 32 vjeç, aktore teatri

“Askush nuk mund të manipulojë askënd. Në një marrëdhënie, të dyja palët e dinë se ç’bëjnë, paçka se njëri prej tyre ankohet pastaj se është përdorur”.

Këtë thoshte Athina, po sillej ndryshe, sepse më përdori dhe më manipuloi, e nuk i mori fare parasysh ndjenjat e mia. Çështja bëhet edhe më serioze kur flasim për magjinë; në fund të fundit ishte mësuesja ime, e ngarkuar që të përçonte misteret e shenjta, që të zgjonte forcën e panjohur që zotërojmë të gjithë. Kur guxojmë të futemi në këtë det të panjohur, u besojmë verbërisht atyre që na drejtojnë, duke menduar se dinë më shumë nga ne.

Por mund t’ju them me siguri se nuk është kështu. Nuk dinin më shumë as Athina, as Eda, e as njerëzit që njoha nëpërmjet tyre. Më thoshte se mësonte edhe ajo vetë ndërkohë që u mësonte të tjerëve, e megjithëse në krye nuk doja ta besoja, më vonë u binda që ndoshta mund të ishte e vërtetë.

Arrita të zbuloja se ishte një nga mënyrat e saj të shumta për të na bërë ta ulnim vigjilencën e t'i dorëzoheshim hirit të saj.

Njeriu që është në kërkim të shpirtërores nuk mendon: do rezultate. Dëshiron të ndihet i fuqishëm, larg turmave anonime. Dëshiron të jetë i veçantë. Athina luante me këto ndjenja të të tjerëve në mënyrë të frikshme.

Kam përshtypjen se dikur kishte ndjerë admirim të thellë për shën Terezën e Lisjësë. Besimi katolik nuk më intereson, por, nga ato që kam dëgjuar, Tereza kishte njëfarë bashkimi mistik dhe fizik me Zotin. Një herë, Athina përmendi se do t'i pëlqente që fati i saj t'i ngjante fatit të Terezës: po të ishte kështu, duhej të kishte hyrë në ndonjë kuvend dhe t'ia përkushtonte jetën meditimit dhe shërbimit ndaj të varfërve. Do të ishte shumë më e dobishme për botën dhe shumë më pak e rrezikshme se t'i shtynte njerëzit, nëpërmjet muzikës dhe ritualeve, drejt njëfarë “intoksikimi” nëpërmjet të cilit mund të arrish tek ajo çka ke më të mirë brenda vetes, por edhe te më e keqja.

E ndoqa duke kërkuar një përgjigje për kuptimin e jetës sime, megjithëse u mundova ta fshihja në takimin tonë të parë. Duhej ta kisha kapur qysh në fillim se Athinës kjo nuk i interesonte shumë; ajo donte të jetonte, të vallëzonte, të bënte dashuri, të udhëtonte, të mblidhte rreth vetes njerëz për t'u

treguar sa e ditur ishte, të mburrej me dhuntitë e saj, të provokonte fqinjët, të përfitonte nga gjithçka që kemi prej profani, ndonëse përpiquej t'i jepte një lustër shpirtërore kërkimit të saj.

Sa herë që shiheshim, në ceremonitë magjike, ose për të shkuar në ndonjë bar, ndjeja pushtetin e saj; e shfaqte me një forcë të tillë sa që pothuajse mund ta prekja. Në krye, mbeta e mrekulluar, doja të isha si ajo. Porse një ditë, në një bar, filloi të fliste për “Ritin e Tretë”, që ka të bëjë me seksualitetin. Para të fejuarit tim. Preteksti ishte të më mësonte. Por mendoj se qëllimi i saj ishte të joshte burrin që dashuroja.

E, padyshim, më në fund ia arriti.

Nuk është mirë të flasësh për njerëzit që e kanë lënë këtë botë për të shkuar në qiell. Athina nuk duhet të më japë llogari mua, por të gjitha atyre forcave që i përdori vetëm për të përfituar vetë, në vend që t'i kanalizonte drejt të mirës së njerëzimit dhe përkryerjes së vet shpirtërore.

Më e keqja është se gjithçka që filluam së bashku mund të kishte dalë mirë po të mos kishte pasur një ekzibicionizëm të sëmurë. Po të ishte më e matur, sot do të ishim të dyja duke përmbushur misionin që na u besua. Por ajo nuk dinte ta kontrollonte veten: besonte se ishte pronare e së vërtetës, e aftë për t'i kapërcyer çdo pengesë duke përdorur vetëm forcën e saj të joshjes.

E cili qe përfundimi? Mbeta vetëm. Nuk mund ta lë punën përgjysmë, duhet të arrij deri në fund, megjithëse herë-herë ndihem e dobët dhe pothuajse përherë e shkurahtar.

Nuk çuditem që jeta e saj mbaroi ashtu: jetonte duke flirtuar me rrezikun. Thonë se personat e hapur janë më të pafat se ata që janë të mbyllur dhe se kërkojnë ta kompensojnë këtë duke i treguar vetes që janë të kënaqur, të gëzuar, në paqe me jetën; të paktën në rastin e saj, ky koment është krejt i vërtetë.

Athina ishte e ndërgjegjshme për karizmin e saj dhe i bëri të vuajnë të gjithë ata që e deshën.

Përfshi edhe mua.

Deidre O’Nill, 37 vjeç, mjeke, njihet si Eda

Në qoftë se një burrë që nuk e njohim fare na merr sot në telefon, bisedojmë pak, nuk ngacmon me nënkuptime, nuk thotë asgjë të veçantë, po megjithatë na kushton vëmendje, gjë që zakonisht nuk na ndodh, jemi në gjendje të biem në shtrat me të po atë natë pak a shumë të dashuruara. Kështu jemi, e kjo nuk ka asgjë të keqe; është në vetë natyrën e femrës që të hapet ndaj dashurisë me lehtësi të madhe.

Ishte kjo dashuri që më bëri të takohesha me Nënë kur isha nëntëmbëdhjetë vjeç. Edhe Athina kishte po atë moshë kur hyri për herë të parë në trans nëpërmjet vallëzimit. Por kjo ishte e vetmja gjë e përbashkët që kishim: moshën e inicimit.

Në gjithçka tjetër ishim krejt të ndryshme, sidomos në mënyrën që kishte secila për t’u marrë vesh me të tjerët. Si mësuese, gjithmonë dhashë çka kisha më të mirë, që të mund të organizoja kërkimin e saj të brendshëm. Si mike - ndonëse nuk jam e sigurt që kjo ndjenjë ishte e ndërsjelltë - u përpoqa ta

paralajmëroja se bota ende nuk ishte e përgatitur për ndryshimet që ajo kërkonte të nxiste. Më kujtohet se mbeta disa net pa gjumë derisa vendosa që ta lejoja të vepronte në liri të plotë, ashtu siç i thoshte zemra.

Problemi i saj i madh ishte se, duke qenë një grua e shekullit XXII, jetonte në shekullin XXI dhe lejonte që këtë ta kuptonin të gjithë. Pagoi ndonjë çmim? Padyshim. Po do të kishte paguar një çmim ku e ku më të lartë po ta kishte ndrydhur dalldinë e saj. Do të ndihej e hidhëruar, e zhgënjyer, gjithmonë e shqetësuar se “çfarë do të mendojnë të tjerët”, gjithmonë duke thënë “më lërë t’i zgjidh këto probleme, pastaj do t’i përkushtohem ëndrrës time”, duke u ankuar vazhdimisht për “rrethanat ideale që kurrë nuk krijohen”.

Të gjithë kërkojnë mësuesin e përkryer; por mësuesit janë qenie njerëzore, ndonëse mësimet e tyre mund të jenë hyjnore, e kjo është diçka që njerëzit mezi e pranojnë. Nuk duhet ngatërruar profesori me leksionin, rituali me ekstazën, përçuesi i simbolit me vetë simbolin. Tradita është e lidhur me takimin me forcat e jetës, jo me personat që e përçojnë. Por jemi të dobët: i kërkojmë Nënës të na dërgojë udhërrëfyes, por ajo dërgon vetëm shenjat e rrugës që duhet të ndjekim.

Mjerë ata që kërkojnë barinj, në vend të dëshirës për liri! Takimin me energjinë e epërme mund ta arrijë kushdo, po është e vështirë për ata që

përgjegjësinë e tyre ua kalojnë të tjerëve. Koha që na takon në këtë botë është e shenjtë, prandaj duhet ta festojmë çdo çast.

Rëndësia e kësaj është harruar krejt: madje edhe ditët e festave fetare janë shndërruar në mundësi për të ikur në plazh, ose në park, ose për të bërë ski. Tashmë nuk ka rituale. Tashmë nuk mund t'i kthejmë veprimet e rëndomta në shfaqje të shenjta. Gatuajmë duke u ankuar për humbjen e kohës, por mund të jemi duke shndërruar në ushqim shumë dashuri. Punojmë duke besuar se ky është një mallkim hyjnor, ndërkohë që duhet t'i përdorim aftësitë tona për të na dhënë kënaqësi dhe për të përhapur energjinë e Nënës.

Athina nxori në sipërfaqe botën aq të pasur që kemi të gjithë në shpirt, pa e kuptuar se njerëzit ende nuk janë të përgatitur për t'i pranuar fuqitë e tyre.

Ne, gratë, kur kërkojmë kuptimin e jetës sonë, ose rrugën e dijes, gjithmonë e identifikojmë veten me ndonjë nga arketipet klasike.

Virgjëreshë (e nuk flas për seksualitetin) është ajo që kërkimin e saj e bën nëpërmjet pavarësisë së plotë, ndërsa gjithçka që mëson është fryt i aftësisë për t'i përballuar sfidat e vetme.

Martirja zbulon te dhimbja, te vetëmohimi dhe te vuajtja një mënyrë për të njohur vetveten.

Shenjtorja gjen te dashuria pa kufi, tek aftësia për të dhënë pa marrë asgjë në këmbim, arsyen e vërtetë të jetës së vet.

Së fundi, Shtriga kërkon kënaqësinë e plotë dhe pa kufi, duke përligjur kësisoj ekzistencën e vet.

Athina ishte te të katërta njëherësh, ndonëse në përgjithësi duhet të zgjedhim vetëm njërën prej këtyre traditave femërore.

Sigurisht që mund ta përligjim sjelljen e saj duke pretenduar se të gjithë ata që hyjnë në gjendje transi apo ekstaze humbin çdo lloj lidhjeje me realitetin. Kjo nuk është e vërtetë: bota fizike dhe bota shpirtërore janë e njëjta gjë. Mund ta shquajmë Hyjnoren te çdo kokrrizë pluhuri, por kjo nuk na pengon ta fshijmë me një leckë të lagur. Hyjnorja nuk zhduket, po shndërrohet në sipërfaqe të pastër.

Athina duhej të kishte pasur më shumë kujdes. Duke u përsiatur mbi jetën dhe vdekjen e ithtares sime, zbuloj se do të ishte më mirë që ta ndryshoja paksa mënyrën e të vepruarit.

Lella Zainab, 64 vjeç, numerologe

Athina? Sa emër interesant! Pa të shohim... numri yt Maksimal është nënta. Optimiste, e shoqërueshme, e aftë për t'u shquar në mes të një turme. Njerëzit të afrohen në kërkim të mirëkuptimit, dhembshurisë, bujarisë, e pikërisht për këtë duhet të jesh tepër e kujdesshme, ngase prirja për popullaritet mund të të bjerë në kokë dhe të të bëjë të humbasësh më shumë se ç'fiton. Gjithashtu duhet të kesh kujdes me ato që thua, se je e prirur të flasësh më shumë se ç'duhet.

Ndërsa numri yt Minimal është njëmbëdhjeta. Mendoj se digjesh për një post drejtues. Të interesojnë temat mistike; nëpërmjet tyre përpiqesh të krijosh harmoni me të gjithë ata që ke përreth.

Por kjo hyn drejtpërdrejt në konflikt me numrin Nëntë, që është shuma e ditës, muajit dhe vitit kur ke lindur, të reduktuara në një algoritëm të vetëm: gjithmonë do të jesh pre e xhelozisë, e trishtimit, e mbylljes në vetvete dhe e vendimeve të rrëmbyera.

Kujdes nga këto ndjenja negative: ambicia e tepruar, intoleranca, shpërdorimi i pushtetit, ekstravaganca.

Për shkak të këtij konflikti, të sugjeroj që t'i kushtohesh diçkaje që nuk kërkon lidhje emocionale me njerëzit, si për shembull, në fushën e informatikës ose të inxhinierisë.

Ka vdekur? Më fal. Çfarë bënte?

Çfarë bënte Athina? Bëri pak nga të gjitha, por në qoftë se do të më duhej të përmblihdja jetën e saj, do të thosha se ishte një priftëreshë që kuptonte forcat e natyrës. Thënë më saktë, ishte dikush që, për faktin e thjeshtë se nuk kishte shumë për të humbur dhe as nuk priste shumë nga jeta, rrezikoi më tepër se të tjerët dhe së fundi u shndërrua në ato forca që besonte se i zotëronte.

Punoi në një supermerkat, në bankë, në një agjenci imobiliare, e në të gjitha këto vende pune nuk la rast pa e shfaqur priftëreshën që kishte brenda vetes. Kam qenë me të tetë vjet të tëra, e këtë ia kisha borxh: të ringjallja kujtimin e saj, identitetin e saj.

Vështirësia kryesore në mbledhjen e këtyre kujtimeve ishte t'i bindja njerëzit që të më lejonin të përdorja emrat e tyre të vërtetë. Disa thanë se nuk donin të përziheshin në histori të tilla, të tjerë përpiqeshin t'i fshihnin opinionet dhe ndjenjat e tyre. U shpjegova se qëllimi im i vërtetë ishte që të gjithë njerëzit e përfshirë në këtë histori ta kuptonin më mirë dhe se askush nuk do t'u besonte deklaratave anonime.

Ngaqë secili prej të intervistuarve besonte se ishte zoti i versionit të vetëm dhe përfundimtar të çfarëdo ngjarjeje, sado e parëndësishme që mund të ishte, më së fundi pranuan. Gjatë regjistrimeve, kuptova se gjërat nuk janë absolute; ekzistojnë në funksion të perceptimit të secilit. Prandaj, shpesh herë, mënyra më e mirë për të ditur cilët jemi është që të përpiqemi të dimë si na shohin të tjerët.

Kjo nuk do të thotë se duhet të bëjmë atë që mendojnë ata, por të paktën e kuptojmë veten më mirë. Unë, për vete, ia kisha borxh Athinës.

Të ringjallja historinë e saj. Të shkruaja mitin e saj.

**Samira R. Khalil, 57 vjeç,
shtëpiake, nëna e Athinës**

Mos e quaj Athina, të lutem. Emri i saj i vërtetë është Sherina. Sherina Khalil, bija jonë shumë e dashur, shumë e dëshiruar, që edhe unë, edhe burri im do të donim ta kishim pasur për veten tonë!

Po jeta pati plane të tjera; kur bujaria e fatit është e madhe, gjithmonë ka një pus ku mund të bien të gjitha ëndrrat.

Jetonim në Bejrut, në kohën kur të gjithë e konsideronin si qytetin më të bukur të Lindjes së Mesme. Burri im ishte sipërmarrës i suksesshëm, u martuam me dashuri, udhëtonim për vit në Europë, kishim miq, na ftonin në çdo ngjarje të rëndësishme shoqërore, ndërsa një herë erdhi madje në shtëpinë time një president i Shteteve të Bashkuara. Merre me mend vetë! Kaluam tre ditë të paharrueshme: dy ditë përgjatë të cilave Shërbimi Sekret amerikan kontrollloi me imtësi çdo cep të shtëpisë (kishin afro një muaj që vërtiteshin në lagje, duke zënë të

gjitha pozicionet strategjike, duke marrë me qira apartamente, duke u maskuar si lypsa apo si çifte të dashuruarish); dhe një ditë, apo më mirë të them, dy orë festë. Kurrë nuk do ta harroj zilinë në sytë e miqve tanë dhe as gëzimin ngaqë mundëm të dilnim në fotografi me njeriun më të fuqishëm të planetit.

I kishim të gjitha, përveç asaj që dëshironim më shumë: një fëmijë. Pra, nuk kishim asgjë.

Provuam gjithçka, premtuam, shkuam në vende ku na garantonin mrekullinë, u këshilluam me mjekë specialistë, me mjekë popullorë, bëmë kura, pimë eliksire dhe barëra magjike. Bëra dy herë inseminim artificial, porse e humba fëmijën. Herën e dytë humba edhe vezoren e majtë, e nuk gjeta më ndonjë mjek tjetër që të guxonte t'i hynte sërishmi një aventure të tillë.

Derisa një nga miqtë tanë të shumtë që e dinin gjendjen tonë na sugjeroi zgjidhjen e vetme të mundshme: birësimin e një fëmije. Na tha se kishte të njohur në Rumani dhe se procesi nuk do të zgjaste shumë.

Një muaj më vonë, i hipëm avionit; miku ynë bënte biznese të rëndësishme me diktatorin që qeveriste vendin asokohe, po emri i këtij nuk më kujtohet (*Shën.: Nikolae Çausheku*), kështu që shmangëm të gjitha formalitetet burokratike e shkuam drejt e në një qendër birësimi në Sibiu,

në Transilvani. Atje ishin duke na pritur me kafe, cigare, ujë mineral e me të gjitha dokumentet gati, na mbetej vetëm të zgjidhnim fëmijën.

Na çuan në një dhomë shumë të ftohtë, e unë pyesja veten se si mund t'i mbanin ato krijesa të mjera në atë gjendje. Gjëja e parë që ndjeva instinktivisht qe dëshira për t'i birësuar të gjithë, t'i merrja në vendin tonë, ku kishte diell dhe liri, por padyshim që ishte një mendim i marrëzishëm. Kalonim midis shtretërve, mes të qarave, me panik për vendimin që duhej të merrnim.

Për më se një orë, as unë, as burri im nuk folëm. Dolëm, pimë kafe, pimë cigare, u kthyem, e kështu disa herë me radhë. Vura re se gruaja që ishte ngarkuar për këtë birësim filloi ta humbiste durimin, duhej të vendosja shpejt; atë çast, duke iu bindur një instinkti, që do të merrja guximin ta quaja instinkt prej nëne, si të kisha gjetur tek ai mishërim një fëmijë që duhej të ishte i imi, por që kishte ardhur në këtë botë nëpërmjet një barku tjetër, tregova me gisht një vajzë.

Gruaja na sugjeroi që ta mendonim edhe një herë. Ajo, që dukej aq e paduruar nga vonesa jonë! Por unë tashmë e kisha vendosur.

Megjithatë, me shumë kujdes, duke u përpjekur të mos lëndonte ndjenjat e mia (ajo mendonte se kishim lidhje me sferat më të larta të qeverisë rumune) më pëshpëriti ngadalë që të mos dëgjonte burri im.

- E di që nuk do të dalë mirë. Është e bija e një ciganeje.

Iu përgjigja se një kulturë nuk mund të përçohet nëpërmjet gjeneve; vajza, që nuk ishte me shumë se tremuajshe, do të ishte bija ime dhe e burrit tim, e do të edukohet sipas zakoneve tona. Do të shkonte në kishën ku shkonim ne, në plazhet ku dilnim shëtitje, do të lexonte libra në frëngjisht, do të studionte në Shkollën Amerikane të Bejrutit. Përveç kësaj, nuk dija asgjë - e vazhdoj të mos di - mbi kulturën cigane. Di vetëm që udhëtojnë, që nuk lahen shpesh, që mashtrojnë të tjerët e që mbajnë një vëth. Legjendat thonë se e kanë zakon të rrëmbejnë fëmijë për t'i marrë në karvanët e tyre, por tani po ndodhte krejt e kundërta: kishin braktisur një vajzë, që të kujdesesha unë për të.

Gruaja u përpoq përsëri të më ndërronte mendjen, por unë po firmosja dokumentet dhe po i kërkoja tim shoqi të bënte të njëjtën gjë. Kur u kthyem në Bejrut, gjithçka dukej ndryshe: Zoti më kishte dhënë një arsye për të jetuar, për të punuar, për të luftuar në këtë luginë lotësh. Tani kishim një vajzë, çka i përlligjte krejt mundimet tona.

Sherina u rrit mes dijes dhe bukurisë (besoj se të gjithë prindërit thonë të njëjtën gjë, por mendoj se ishte një vajzë vërtet e jashtëzakonshme). Një mbrëmje, kur i kishte mbushur pesë vjeç, një nga vëllezërit e mi tha se, po do të donte të punonte jashtë vendit, nga emri të gjithë do t'ia kuptonin

originën dhe na sugjeroi që t'ia ndërronim me një emër që nuk thotë absolutisht asgjë, Athina, për shembull. Padyshim, tani e di se Athina nuk është vetëm kryeqyteti i një vendi, po edhe perëndesha e dijes, e zgjuarsisë dhe e luftës.

Me gjasë, im vëlla jo vetëm që e dinte këtë, po edhe ishte i ndërgjegjshëm për problemet që mund t'i nxirrte një emër arab në të ardhmen (merrej me politikë, sikurse krejt familja jonë, dhe donte ta mbronte të mbesën nga retë e zeza që ai, vetëm ai, mund t'i shquante në horizont). Më e çuditshmja është se Sherinës i pëlqeu tingëllimi i fjalës. Mjaftoi një mbrëmje që të fillonte ta quante veten Athina, dhe kështu askush nuk mund t'ia hiqte më nga koka. Për t'i bërë qejfin, filluam ta përdornim edhe ne këtë nofkë, duke menduar se shpejt do ta harronte.

A mundet që emri të ndikojë në jetën e një njeriu? Sepse koha kalonte, nofka doli e qëndrueshme dhe ne më në fund u mësuaam me të.

Kur ishte dymbëdhjetë vjeç, zbuluam se kishte njëfarë prirjeje për fenë: kalonte orë të tëra në kishë, e dinte përmendësh ungjillin, gjë që ishte njëherësh fat dhe mallkim. Në një botë që po fillonte të ndahej gjithmonë e tepër sipas besimeve fetare, shqetësohesha për sigurinë e sime bije. Tamam në atë kohë, Sherina kishte filluar të na thoshte, si të ishte gjëja më e natyrshme në botë, se kishte një sërë miqsh të padukshëm, engjëj e shenjtore, shëmbëlltyrat e

të cilëve i shihte në kishën ku shkonim. Dihet se të gjithë fëmijët kanë vegime, ndonëse është e çuditshme që t'i kujtojnë pasi kalojnë një moshë të caktuar. Po ashtu, e kanë zakon t'u japin jetë gjërave të pajeta, sikurse kukullave apo arushave prej gëzofi. Por fillova të mendoja se po e tepronte kur një ditë që po e merrja nga shkolla më tha se kishte parë “një grua të veshur me të bardha, që i ngjante Shën Mërisë”.

Besoj tek engjëjt, sigurisht. Madje, besoj edhe se engjëjt u flasin fëmijëve të vegjël, po kur vegimet i shfaqen një të rrituri është tjetër gjë. Kam dëgjuar histori barinjsh apo fshatarësh që pohojnë se kanë parë një grua veshur me të bardha, gjë që do t'ua shkatërronte jetën, se njerëzit do t'u kërkonin për të bërë mrekulli, priftërinjtë do të shqetësoheshin, fshati do të shndërrohej në vend pelegrinazhi, ndërsa fëmijët e shkretë do ta mbyllnin jetën në ndonjë manastir. Prandaj dhe më shqetësoi së tepërmi ajo histori; në moshën që kishte, duhej të interesohej më shumë për kutitë e tualetit, për ngjyrën e manikyrit, për telenovelat romantike ose programet e fëmijëve në televizor. Diçka nuk shkonte mirë te vajza ime, kështu që vendosa të takoja një specialist.

- Qetësohuni, - më tha ai.

Për pediatri e specializuar në psikologjinë e fëmijëve, sikurse për shumicën e mjekëve që merren me këto fusha, miqtë e padukshëm janë një farë projektimi i ëndrrave, që e ndihmojnë fëmijën

të zbulojë dëshirat e veta, të shprehë ndjenjat, të zbulojë veten, pa pasur asnjë rrezik.

- Po gruaja me të bardha?

M'u përgjigj se, ndoshta, Sherina nuk e kuptonte mënyrën se si e shohim apo si e shpjegojmë botën. Më sugjeroi që, pak nga pak, të fillonim të përgatisnim terrenin për t'i thënë se ishte e birësuar. Sipas specialistit, gjëja më e keqe që mund të ndodhte ishte që ta merrte vesh vetë, sepse do të fillonte të dyshonte te të gjithë. Sjellja e saj mund të bëhej e paparashikueshme.

Qysh nga ai çast, e ndryshuam mënyrën e të dialoguarit me të. Nuk e di nëse qenia njerëzore mund të kujtojë gjëra që i kanë ndodhur kur ka qenë ende foshnje, po u përpoqëm t'i tregonim sa shumë e donim dhe se s'kishte pse të mundohej në një botë imagjinare. Duhej ta kuptonte se universi i saj i dukshëm ishte më i mrekullueshmi, se prindërit do ta mbronin nga çfarëdolloj rreziku, se Bejruti ishte i bukur, se plazhet ishin përherë plot diell dhe njerëz. Pa iu kundërvënë drejtpërdrejt asaj "gruaje", fillova të kaloja më shumë kohë me time bijë, ftova shokët e saj të shkollës të vinin në shtëpi, nuk lija të më shpëtonte rasti për t'i treguar gjithë dashurinë tonë.

Strategjia dha frytet e saj. Burri im udhëtonte shumë, Sherinën e merrte malli dhe, në emër të dashurisë për të, ai vendosi ta ndryshonte mënyrën e jetës. Bisedat e vetmuara filluan të zëvendësohen nga lojra mes babait, nënës dhe vajzës.

Gjithçka shkonte mirë derisa një natë erdhi duke qarë në dhomën time e më tha se kishte frikë, se ferri ishte afër.

Isha vetëm; tim shoqi, edhe kësaj here, i qe dashur të ikte, dhe mendova se ndoshta prandaj ishte e dëshpëruar. Ah! Dreqi ta marrë! Çfarë i mësonin në shkollë a në kishë? Vendosa që të nesërmen të shkoja e të flisja me mësuesen.

Sherina nuk pushonte së qari. E çova te dritarja, i tregova Mesdheun, atje tutje, i ndriçuar nga hëna e plotë. I thashë se s'kishte djaj, po yje në qiell dhe njerëz që ecnin bulevardit para pallatit tonë. I shpjegoja se nuk duhej të kishte frikë, se duhej të qetësohej, por ajo vazhdonte të qante e të dridhej. Pasi kaloi më se gjysmë ore që përpiqesha ta qetësoja, fillova të bëhesha nervoze. I thashë që nuk duhej të sillej më ashtu, se nuk ishte më fëmijë. Më shkoi në mendje se ndoshta i kishin ardhur periodat për herë të parë; me marifet e pyeta se mos i kishte dalë gjak.

- Shumë.

Mora pak pambuk, i thashë të shtrihej që të mund t'ia kuroja "plagën". S'ishte asgjë, të nesërmen do t'ia shpjegoja. Sidoqoftë, s'i kishin ardhur periodat. Qau dhe pak, po duhej të ishte e lodhur, sepse menjëherë e zuri gjumi.

Dhe të nesërmen në mëngjes, vërshoi gjaku.

Katër burra u vranë. Për mua, nuk ishte veçse një nga luftërat e përjetshme fisnore me të cilat

vendi im ishte mësuar. Për Sherinën s'kishte qenë asgjë, me sa dukej, se as që e përmendi ëndrrën e një nate më parë.

Megjithatë, duke filluar nga ajo natë, ferri filloi të zinte vend, dhe as sot e kësaj dite ende nuk ka ikur. Po atë ditë, pati njëzet e gjashtë palestinezë të vdekur në një autobus, si hakmarrje për vrasjen. Njëzet e katër orë më pas, nuk mund të dilje më në rrugë, për shkak të të shtënave që vinin nga të gjitha anët. Shkollat u mbyllën. Sherinën e solli me të shpejtë në shtëpi një nga mësueset e veta dhe, që nga ai çast, askush nuk e kishte situatën në dorë. Im shoq e ndërpreu udhëtimin dhe u kthye në shtëpi; kaloi ditë të tëra duke telefonuar miqtë që kishte në qeveri, po askush nuk i jepte ndonjë shpjegim për të qenë. Sherina dëgjonte të shtënat që vinin nga jashtë, britmat e tim shoqi brenda shtëpisë dhe, për çudinë time, nuk thoshte asnjë fjalë. Tërë kohës përpiqesha t'i thosha se ishte diçka kalimtare, se shpejt do të mund të shkonim në plazh, por ajo m'i shmangte sytë dhe më kërkonte ndonjë libër për të lexuar, ose ndonjë disk për të dëgjuar. Në kohën që ferri po zinte vend pak nga pak, Sherina lexonte e dëgjonte muzikë.

Më fal, por nuk dua të mendoj shumë për këto gjëra. Nuk dua të mendoj për kërcënimet që patëm, kush kishte të drejtë, kush ishte fajtor e kush i pafajshëm. Fakti është se, pak muaj më pas, po të doje të kapërceje rrugën, duhej të merrje një barkë, të

shkoje deri në ishullin e Qipros, të merrje një barkë tjetër e të zbarkoje në trotuarin tjetër të rrugës.

U mbyllëm në shtëpi thuajse një vit të tërë, vazhdimisht me shpresën që situata do të përmirësohej, vazhdimisht me mendimin se të gjithë këto që po ndodhnin qenë kalimtare, se qeveria do ta kontrollonte situatën. Një mëngjes, tek dëgjonte muzikë në kasetofonin e saj të vogël, Sherina provoi disa hapa vallëzimi dhe filloi të thoshte gjëra të tilla si “do të zgjasë shumë, shumë kohë”.

Desha ta ndërprisja, po im shoq më kapi nga krahu: po i kushtonte vëmendje dhe po i merrte seriozisht fjalët e një fëmije. Asnjëherë nuk e kuptova pse, e deri më sot nuk kemi folur për atë gjë; është një çështje tabu mes nesh.

Të nesërmen, papritmas, ai filloi të bënte disa përgatitje; pas dy javësh do të merrnim një anije për në Londër. Megjithëse ende nuk ka statistika të sakta për atë që ndodhi, më vonë mësuam se, gjatë dy vjetëve që vazhdoi lufta civile (*Shën.: 1974 dhe 1975*), pati rreth dyzet e katër mijë të vdekur, njëqind e tetëdhjetë mijë të plagosur, mijëra e mijëra refugjatë. Luftimet vazhduan për arsye të tjera, vendi u pushtua nga forca të huaja, ndërsa ferri vazhdon edhe sot e kësaj dite.

“Do të vazhdojë për shumë kohë”, thoshte Sherina. O Zot, për fat të keq kishte të drejtë!

**Lukas Jesen-Petersen, 32 vjeç,
inxhinier, ish-bashkëshorti**

Athina e dinte se ishte e birësuar, që kur e takova për herë të parë. Ishte nëntëmbëdhjetë vjeç dhe po bëhej gati të fillonte një zënie në kafenenë e universitetit, sepse dikush, duke menduar se ajo ishte me prejardhje angleze (e bardhë, me flokë të drejtë, me sy herë jeshilë, herë gri) kishte bërë një koment përçmues rreth Lindjes së Mesme.

Ishte dita e parë e shkollës; të gjithë ishin të rinj, askush nuk dinte asgjë për tjetrin. Mirëpo ajo vajza u ngrit, e kapi tjetrën nga fyti e filloi të bërtiste si e marrë:

- Raciste!

Pashë vështrimin e tmerruar të vajzës tjetër, vështrimin e përndezur të studentëve përfaqark tyre, të etur për të parë çfarë do të ndodhte. Ngaqë isha një vit më i madh se të tjerët, menjëherë munda t'i merrja me mend pasojat: zyra e rektorit, ankesa, gjasa përjashtimi, hetim policor mbi racizmin, etj. Të gjithë mund të dilnin të humbur.

- Pushoni! – bërtita, pa e ditur ç'po thosha.

Nuk njihja asnjërin prej tyre. Nuk jam shpëtimtari i botës dhe, të them të drejtën, ndonjë grindje tek-tuk është ngacmuese për të rinjtë. Po britma dhe reagimi dolën më të forta se unë.

- Mjaft! - i bërtita edhe një herë vajzës simpatike, që e kishte zënë për fyti tjetrën, edhe kjo mjaft simpatike.

Më pa dhe më ngriu në vend me shikimin e saj. Papritur, diçka ndryshoi. Ajo buzëqeshi, ndonëse ende i kishte duart te fyti i tjetrës.

- Harrove të thuash të lutem.

Qeshën të gjithë.

- Mjaft, - i thashë. - Të lutem.

E lëshoi vajzën dhe erdhi drejt meje. Të gjithë e ndoqën me sy.

- Paske edukatë. A ke edhe cigare?

I zgjata paketën dhe dolëm të pinim cigare në oborr. Kishte kaluar nga tërbimi i plotë në qetësi absolute, e mbas një çike po qeshte, po fliste për motin, po më pyeste cili grup muzikor më pëlqente. Dëgjova zilen e fillimit të leksionit, po as që m'u bë vonë për atë gjë me të cilën më kishin edukuar gjithë jetën: për disiplinën. Ndenja aty duke u fjalosur, si të mos ekzistonte më universiteti, as grindjet, as kafeneja, as era, as të ftohtit dhe as dielli. Ekzistonte vetëm ajo vajzë me sy gri, që thoshte

gjëra të parëndësishme e pa interes, të afta për të më mbajtur aty gjithë jetën.

Dy orë më vonë, po hanim së bashku. Shtatë orë më vonë, ishin në një bar, duke ngrënë darkë e duke pirë me ato pak para që kishim. Bisedat filluan të bëhen gjithnjë e më të thella dhe brenda një kohe të shkurtër mësova pothuajse krejt jetën e saj: Athina më tregonte hollësisht nga fëmijëria e vet dhe nga adoleshenca, pa i bërë asnjë pyetje. Më vonë, mësova se ashtu sillej me të gjithë; sidoqoftë, atë ditë, u ndjeva mashkulli më i veçantë në faqe të dheut.

Kishte ardhur në Londër si refugjate e luftës civile që pati shpërthyer në Liban. I ati, një i krishterë maronit (*Shën.: Degëzim i Kishës Katolike, i cili, ndonëse i nënshtrohet autoritetit të Vatikanit, nuk kërkon beqarinë e priftërinjve dhe praktikon rite orientale e ortodokse*), ishte kërcënuar me vdekje sepse punonte për qeverinë, e megjithatë nuk vendoste të shkonte në mërgim, derisa Athina, që dëgjoi fshehurazi një bisedë telefonike, vendosi që kishte ardhur ora të rritej, të merrte mbi vete përgjegjësitë ndaj prindërve dhe t'i mbronte ata njerëz që aq shumë i donte.

Provoi njëfarë vallëzimi, u shtir se kishte hyrë në trans (i kishte mësuar ato gjëra në shkollë, kur studionte jetën e shenjtorëve) dhe filloi të fliste. Nuk e di si mund t'ia arrijë një fëmijë t'i bëjë të rriturit që të marrin vendime duke u nisur nga thëniet e saj, po Athina ngulmonte se ndodhi pikërisht kështu, i

ati i ishte besëtyt, ajo ishte krejt e sigurt se i kishte shpëtuar jetën familjes.

Mbërritën këtu si refugjatë, por jo si lypës. Komuniteti libanez është i shpërndarë në gjithë botën, i ati e gjeti menjëherë si ta rifillonte biznesin e tij dhe jeta vazhdoi. Athina arriti të studionte në kolegje të mira, dha mësimë vallëzimi - që ishte pasioni i saj – dhe, kur mbaroi shkollën e mesme, zgjodhi Fakultetin e Inxhinierisë.

Pasi erdhën në Londër, prindërit e ftuan për darkë në një nga restorantet më të shtrenjta të qytetit dhe, me kujdesin më të madh i treguan, se ishte e birësuar. Ajo u shtir sikur po çuditej, i përqafoi dhe u tha se asgjë nuk do të ndryshonte në marrëdhënien mes tyre.

Por, në të vërtetë, ndonjë kushëri, në ndonjë çast inati, i pati thënë “jetime bukëshkalë, as prindër s’ke dhe as di të sillesh”. Ajo e goditi në fytyrë me një tavëll duhani, qau dy ditë të tëra, por shpejt e pranoi atë gjë. Atij kushëririt i mbeti një shenjë në fytyrë, që nuk mund t’ia shpjegonte askujt, prandaj filloi të thoshte se e kishin sulmuar disa grabitës në rrugë.

E ftova të dilnim të nesërmen. Pa asnjë droje, më tha se ishte e virgjër, se shkonte në kishë çdo të diel dhe se nuk i pëlqenin romancat; i pëlqente më tepër të lexonte ç’të mundej mbi situatën në Lindjen e Mesme.

Pra, ishte e zënë. Shumë e zënë.

- Njerëzit mendojnë se ëndrra e vetme e një gruaje është që të martohet e të bëjë fëmijë. Dhe, nga të gjitha ato që të tregova, besoj se pandeh që kam vuajtur shumë në jetë. Nuk është e vërtetë, dhe e njoh këtë stil, nuk është hera e parë që më afrohet një burrë kinse “për të më mbrojtur” nga tragjeditë. Harrojnë se, qysh nga Greqia e lashtë, njerëzit që ktheheshin nga luftërat vinin ose të vdekur e të mbuluar me shqyt, ose, ata më të fortët, të mbuluar me plagë. Sa për dijeni: gjendem në fushë të betejës që kur kam lindur, vazhdoj të jetoj dhe nuk kam nevojë që të më mbrojë kurrkush.

Bëri një pauzë.

- E sheh sa e kulturuar jam?

- Shumë e kulturuar, po kur sulmon dikë më të dobët se vetja, lë të kuptohet se në të vërtetë ke nevojë për mbrojtje. Pak më parë mund ta kishe shkatërruar karrierën tënde universitare.

- Ke të drejtë. E pranoj ftesën.

Që nga ajo ditë, filluam të dilnim rregullisht bashkë dhe, sa më pranë saj qëndroja, aq më shumë zbuloja zgjuarsinë time. Sepse ajo më nxiste që të jepja çka kisha më të mirë brenda vetes. Kurrë nuk kishte lexuar ndonjë libër magjie apo ezoterizmi: thoshte se ishin gjëra të djallit, se shpëtimi i vetëm ishte te Jezui dhe pikë. Herë-herë, e hidhte fjalën te gjëra që sikur s’përputheshin me mësimet e Kishës:

- Krishti ishte i rrethuar nga lypës, prostituta, tagrambledhës, peshkatarë. Besoj se me këtë donte të thoshte që shkëndija hyjnore gjendet në shpirtrat e të gjithëve, që nuk shuhet kurrë. Tek rri në qetësi, ose kur jam shumë e shqetësuar, ndiej që dridhem së bashku me krejt universin. Filloj të njoh gjëra që nuk i njoh, si të jetë vetë Zoti që m'i drejton hapat. Ka çaste që ndiej se gjithçka zbulohet para meje.

Pastaj e ndreqte:

- Është gabim.

Athina gjithmonë jetonte mes dy botëve: në atë që e ndiente si të vërtetë dhe në atë që i kishin mësuar nëpërmjet besimit.

Një ditë, mbas gati një semestri ekuacionesh, llogaritjesh e studimi strukturash, tha se do ta linte fakultetin.

- Po ti s'më kishe thënë asgjë!

- Kisha frikë të flisja për këtë, madje edhe me veten time. Por sot shkova në floktore; floktarja ka punuar ditë e natë që e bija të mbaronte sociologjinë. Vajza arriti ta mbaronte fakultetin dhe pasi trokiti derë më derë, më në fund gjeti punë si sekretare në një firmë çimentoje. E megjithatë, floktarja përsëriste sot, shumë krenare: "Ime bijë është me diplomë". Shumica e miqve të prindërve të mi dhe fëmijët e miqve të prindërve të mi kanë diplomë. Kjo nuk do të thotë se kanë arritur të punojnë atje ku duan. Përkundrazi, e filluan dhe

e mbaruan universitetin sepse dikush, në një kohë kur universiteti dukej si i rëndësishëm, tha se, që të ecësh përpara në jetë, duhet të kesh diplomë. Dhe bota mbeti pa kopshtarë, bukëpjekës, antikuarë, muratorë e shkrimtarë të shkëlqyer.

I thashë që të mendohej edhe një herë para se të merrte një vendim kaq të rëndësishëm. Por ajo më citoi vargjet e Robert Frostit:

*Në një pyll bigëzoheshin dy rrugë dhe unë...
unë mora atë që rrihej më pak.
Dhe gjithçka ishte ndryshe.*

Të nesërmen nuk erdhi. Kur u takuam prapë, e pyeta se çfarë do të bënte.

- Do të martohem. Dhe do të bëj një fëmijë.

Nuk ishte ultimatium. Unë isha njëzet vjeç, ajo nëntëmbëdhjetë dhe mendoja se ende ishte shumë herët për një angazhim të tillë.

Po Athina fliste shumë seriozisht. Ndërsa mua më duhej të zgjidhja mes humbjes së të vetmes gjë që vërtet i zinte krejt mendimet e mia - dashurisë për atë grua - dhe humbjes të lirisë dhe mundësive që më premtonte e ardhmja.

Sinqerisht, vendimi nuk m'u duk aspak i vështirë.

Patër Xhankarlo Fontana, 72 vjeç

Sigurisht që u çudita kur ai çift aq i ri erdhi në kishë e na kërkoi që t'i organizonim ceremoninë e dasmës. E njihja pak Lukas Jesen-Petersenin dhe po atë ditë mora vesh se familja e tij, me një prejardhje të errët fisnike nga Danimarka, i kundërvihej haptazi këtij bashkimi. Jo vetëm martesës, po edhe Kishës.

Babai i tij, mbështetur në argumente shkencore deri diku të pakundërshtueshme, thoshte se Bibla, mbi të cilën bazohet krejt feja, në të vërtetë nuk ishte një libër, porse një përmbledhje e 66 dorëshkrimeve të ndryshme, që nuk u dihet as emri i vërtetë e as autori; se nga libri i parë tek i fundit kaluan gati një mijë vjet dhe se madje ishte shkruar pasi Kolombi zbuloi Amerikën. Se asnjë qenie e gjallë në mbarë planetin - që nga majmunët e deri te zogjtë - nuk ka nevojë për dhjetë urdhërime për të ditur si të silltet. Gjëja më e rëndësishme është që të ndjekim ligjet e natyrës dhe bota do të jetë në harmoni.

Sigurisht që e lexoj Biblën. Sigurisht që di diçka për historinë e saj. Por qeniet njerëzore që e shkruan ishin instrumente të Fuqisë Hyjnore, ndërsa Jezui krijoi një bashkim shumë më të fortë se dhjetë urdhërimet: dashurinë. Zogjtë, majmunët, apo cilado krijesë e Zotit që mund të përmendim, u binden instinkteve të tyre dhe ndjekin vetëm atë çka është e programuar. Në rastin e qenies njerëzore, gjërat janë më të ndërlikuara, sepse ajo njeh dashurinë dhe kurthet e saj.

Por t'i lëmë këto, se po mbaj një predikim kur në të vërtetë duhej të flisja për takimin tim me Athinën dhe Lukasin. Tek po flisja me djalin - them po flisja, sepse nuk i përkasim të njëjtit besim, kështu që nuk i nënshtrohem sekretit të rrëfimit, - mora vesh se, përveç antiklerikalizmit që mbretëronte në shtëpinë e tij, ekzistonte një mosbesim i madh për faktin se Athina ishte e huaj. Desha t'i kërkoja që të paktën të sillte ndër mend një citim të Biblës, ku nuk bëhet asnjë aluzion për besimin, po është thjesht një këshillë:

Mos e urrej idumeasin, sepse është vëllai yt; as egjiptianin mos e quaj të urreyer, sepse i huaj ishe në tokë të tij.

Më falni. Përsëri po citoj Biblën, por ju jap fjalën se që nga ky çast do ta kontrolloj veten. Pasi bisedova me djalin, ndenja të paktën dy orë me Sherinën, apo Athinën, siç i pëlqente asaj ta quanin.

Athina gjithmonë më ka intriguar. Qëkurse filloi të vinte në kishë, m'u duk se kishte një projekt të qartë në kokë: të bëhej shenjtorë. Më tha që, ndonëse i dashuri i saj nuk e dinte, pak para se të shpërthente lufta civile në Bejrut kishte pasur një përvojë shumë të ngjashme me atë të shën Terezës së Lisjësë: kishte parë gjak nëpër rrugë. Mund t'ia mveshim këtë ndonjë traume të fëmijërisë apo të adoleshencës, por në fakt një përvojë e tillë, e njohur si “zotërim krijues i së shenjtës”, u ndodh të gjitha qenieve njerëzore, dikujt më shumë e dikujt më pak. Papritmas, për një çast të shkurtër, ndiejmë se krejt jeta jonë është e përligjur, mëkatet na janë falur, dashuria kurdoherë është më e fortë dhe mund të na ndryshojë përfundimisht.

Por, gjithashtu, tamam në këtë çast ndiejmë frikë. T'i jepesh tërësisht dashurisë, qoftë hyjnore apo njerëzore, do të thotë të heqësh dorë nga gjithçka, madje edhe nga mirëqenia, apo madje edhe nga aftësia për të marrë vendime. Do të thotë të dashurosh në kuptimin më të plotë të kësaj fjale. Në të vërtetë, nuk duam të ndihemi të shpëtuar sipas mënyrës që zgjodhi Zoti: duam të ruajmë kontrollin e plotë mbi hapat që bëjmë, të jemi krejt të ndërgjegjshëm për vendimet që marrim, të jemi të aftë që ta zgjedhim objektin e përkushtimit.

Me dashurinë s'ndodh kështu: vjen, zë vend dhe arrin të kontrollojë gjithçka. Vetëm ndonjë shpirt

shumë i fuqishëm rrëmbehet, dhe Athina ishte një shpirt i fuqishëm.

Aq i fuqishëm sa kalonte orë të tëra në meditim të thellë. Kishte talent të veçantë për muzikë; thoshin se kërcente shumë bukur, mirëpo, meqë kisha nuk është vend i përshtatshëm për këtë gjë, e kishte zakon që çdo mëngjes, para se të shkonte në universitet, të sillte kitarën me vete e të rrinte një copë herë duke i kënduar Virgjëreshës.

Ende më kujtohet se si e dëgjova për herë të parë. Sapo kisha mbaruar meshën e mëngjesit për ata pak besimtarë që janë të gatshëm të zgjohen herët në dimër, kur më ra ndër mend se kisha harruar të merrja paratë që kishin hedhur në kuti. U ktheva dhe dëgjova një muzikë që më bëri të vështroja gjithçka tjetërsoj, a thua ajrin e kish prekur dora e një engjëlli. Në një cep, në njëfarë gjendje transi, një vajzë e re afër të njëzetave këndonte me kitarë disa himne lëvduese, me sytë ngulur në shëmbëlltyrën e Ngjizjes së Papërlyer.

U afrova te kutia. Vajza e ndjeu praninë time dhe ndaloi, po unë ia bëra me kokë, duke e nxitur të vazhdonte. Pastaj u ula në një stol, mbylla sytë dhe po dëgjoja.

Atë çast, ndjesia e Parajsës, “zotërimi krijues i së shenjtës”, u duk se zbriti nga qiejt. Si ta kuptonte çfarë po ndodhte në zemrën time, ajo filloi ta ndërthurte këngën me heshtjen. Kur pushonte, unë thosha një lutje. Pastaj fillonte përsëri muzika.

Isha i ndërgjegjshëm se po jetoja një çast të paharrueshëm të jetës; një nga ato çaste që i kuptojmë vetëm pasi ikin. Isha aty i tëri, pa të kaluar, pa të ardhme, duke jetuar vetëm atë mëngjes, atë muzikë, atë ëmbëlsi, lutjen e papritur. U përfshiva në njëfarë adhurimi, magjepsjeje dhe mirënjohjeje që isha në këtë botë, i lumtur që kisha ndjekur prirjen time pavarësisht prej kundërshtimeve të familjes. Në thjeshtësinë e asaj kishëze të vogël, në zërin e vajzës, në dritën e mëngjesit që përmbyste gjithçka, kuptova edhe një herë se madhështia e Zotit shfaqet përmes gjërave më të thjeshta.

Pas shumë lotësh e pas një kohe që m'u duk se zgjati një shekull, ajo pushoi. Ktheva kokën, pashë se ishte një nga besimtarët që vinin në kishë. Qysh atëherë, u bëmë miq dhe, sa herë që mundeshim, bashkoheshim në atë adhurim nëpërmjet muzikës.

Po ideja e martesës më çuditi shumë. Ngaqë kishim afërsi, desha të dija se si mendonte se do ta priste familja e dhëndrit.

- Keq. Shumë keq.

Me shumë takt, e pyeta se mos ndihej e detyruar të martohej për ndonjë arsye.

- Jam e virgjër. Nuk jam shtatzënë.

Desha të dija a u kishte thënë njerëzve të saj dhe më tha se po: reagimi kishte qenë i tmerrshëm, i shoqëruar nga të qarat e nënës dhe nga kërcënimet e babait.

- Tek vij këtu për t'i thurur lavde Virgjëreshës me muzikën time, nuk mendoj se çfarë do të thonë të tjerët; thjesht ndaj me të ndjenjat e mia. Dhe, qysh kur jam në gjendje të arsyetoj, kështu ka qenë gjithmonë; jam një enë ku Energjia Hyjnore mund të shfaqet. Kjo energji më kërkon tani të kem një fëmijë, që të mund t'i japë atë çka nëna ime biologjike kurrë nuk ma dha: mbrojtjen dhe sigurinë.

“Askush nuk është i sigurt në këtë botë”, iu përgjigja. Ende kishte përpara vetes një të ardhme të gjatë, kishte kohë me bollëk për t'iu shfaqur mrekullia e krijimit. Po Athina ishte e vendosur:

- Shën Tereza nuk u rebelua kundër sëmundjes që kishte; përkundrazi, pa tek ajo një shenjë Lavdie. Shën Tereza ishte shumë më e re se unë, ishte pesëmbëdhjetë vjeçe kur vendosi të bëhej murgeshë. Ia ndaluan, por ajo nuk pranoi, shkoi të fliste drejtpërdrejt me Papën! A e merr me mend ç'do të thotë? Të flasësh me Papën! Dhe ia arriti qëllimit. Është e njëjta Lavdi që po më kërkon diçka shumë më të lehtë e më bujare se një sëmundje: të jem nënë. Po të pres gjatë, nuk do të mund të bëhem dot shoqe me fëmijën tim, diferenca e moshës do të jetë e madhe e nuk do të na interesojnë të njëjtat gjëra.

Ngula këmbë se nuk do të ishte e vetmja.

Por Athina vazhdoi, sikur nuk më dëgjonte:

- Jam e lumtur vetëm kur mendoj se Zoti ekziston dhe më dëgjon; kjo nuk mjafton për të vazhduar jetën dhe gjithçka duket pa kuptim. Përpiqem të shpreh gëzime që nuk i ndiej, e fsheh trishtimin për të mos shqetësuar ata që aq shumë më duan e kujdesen për mua. Po para pak kohësh më shkoi mendja te vetëvrasja. Natën, para se të fle, flas gjatë me vete dhe dua ta heq nga koka këtë mendim: do të ishte mosmirënjohje ndaj të gjithëve, arrati, një mënyrë për të përhapur tragjedinë dhe mjerimin mbi dhe. Mëngjeseve vij këtu për të folur me shenjtoreshën, për t'i kërkuar të më çlirojë nga djajtë e natës. Më ka vlejtur deri tani, po kam filluar të ligështohem. E di se më përket një mision që e kam kundërshtuar për një kohë të gjatë, por tani duhet ta pranoj. Ky mision është amësia. Duhet ta përmbush, ndryshe do të çmendem. Në qoftë se nuk mund ta shoh jetën të rritet brenda meje, nuk do të mund të pranoj as jetën që është jashtë.

Lukas Jesen-Petersen, ish-bashkëshorti

Kur lindi Vioreli, unë sapo kisha mbushur njëzet vjeç. Nuk isha më studenti që sapo ishte martuar me një shoqe të fakultetit, por një burrë i përgjegjshëm që mbante familjen, me një peshë të madhe mbi supe.

Natyrisht që prindërit e mi, të cilët as që erdhën në dasmën tonë, më ofronin çfarëdolloj ndihme ekonomike po të ndahesha e të merrja nën kujdes fëmijën (më saktë, ishte im atë që ma tha, sepse nëna zakonisht më merrte në telefon duke qarë e duke më thënë se isha i çmendur, por që gjithësesi dëshironte aq shumë të përqafoje nipin). Shpresoja se, kur ta kuptonin sa shumë e doja Athinën dhe se isha i vendosur të vazhdoja me të, ky qëndrim i tyre do të ndryshonte.

Po nuk ndryshoi. Dhe tani duhej të ushqeja gruan dhe djalin. E lashë Fakultetin e Inxhinierisë. Më telefonoi im atë. Duke më kërcënuar e duke më marrë me të mirë, më tha se, po të vazhdoja ashtu,

do të më përjashtonte nga trashëgimia, por, nëse do t'i kthehesha universitetit, mund të më ndihmonte “përkohësisht”, sipas fjalëve të tij. Refuzova; romantizmi i rinisë kërkon që të mbajmë gjithmonë qëndrime radikale. I thashë se mund t'i zgjidhja vetë problemet e mia. Deri ditën që lindi Vioreli, Athina filloi të më bënte të kuptoja më mirë. Megjithatë, kjo nuk ndodhi nëpërmjet marrëdhënies sonë seksuale - duhet të pohoj se ishte shumë e ndrojtur - por nëpërmjet muzikës.

Muzika është po aq e lashtë sa qenia njerëzore, më shpjeguan më vonë. Paraardhësit tanë, që udhëtonin nga shpella në shpellë, nuk mund të merrnin me vete shumë gjëra, po arkeologjia moderne tregon se, përveç atyre pak gjërave që u duheshin për të ngrënë, në plaçkat e tyre gjithmonë kishte një instrument muzikor, zakonisht një tambur. Muzika nuk është thjesht diçka që na pëlqen, ose që na argëton, po përveç kësaj është edhe ideologji. Njeriu njihet nga lloji i muzikës që dëgjon.

Duke e parë Athinën të vallëzonte kur qe shtatzënë, duke e dëgjuar t'i binte kitarës që foshnja të qetësohej dhe të kuptonte se e donim shumë, fillova të lejoja që mënyra e saj e të parit të botës të ndikonte edhe në jetën time. Kur lindi Vioreli, gjëja e parë që bëra sapo u kthyem në shtëpi ishte dëgjimi i *adaxhios* së Albinonit. Kur grindeshim, pikërisht fuqia e muzikës na ndihmonte që t'i

përballonim çastet e vështira - ndonëse nuk arrita të gjeja ndonjë lidhje logjike mes njëres dhe tjetres, përveçse të më shkonte mendja te hipitë.

Po gjithë ky romantizëm nuk na ndihmonte të fitonim para. Meqë nuk dija t'i bija asnjë vegle muzikore, madje as për të argëtuar klientët në një bar, arrita vetëm të gjeja punë si praktikant në një studio arkitekture, për të bërë llogaritje strukturash. Paganin shumë pak për orë, kështu që dilja nga shtëpia herët dhe kthehesha vonë. Pothuajse nuk e shihja fare tim bir - që gjithmonë e gjeja duke fjetur - e mezi mund të flisja o të bëja dashuri me gruan time, sepse ishte e rraskapitur. Çdo natë pyesja veten: Kur do të përmirësohet gjendja jonë ekonomike e të kemi dinjitetin që meritojmë? Edhe pse isha në një mendje me Athinën kur fliste për kotësinë e diplomës, në shumicën e rasteve, në inxhinieri (sikurse edhe në drejtësi e në mjekësi, për shembull) është e domosdoshme të kesh një sërë njohurish teknike, përndryshe rrezikon jetën e të tjerëve. Por mua më ishte dashur të ndërprisja kërkimin e profesionit që kisha zgjedhur, të një ëndrre që ishte shumë e rëndësishme për mua.

Filluan sherret. Athina ankohej se unë i kushtoja pak vëmendje djalit, që kishte nevojë për një baba, se po të ishte puna thjesht për të pasur një fëmijë, ajo mund ta kishte bërë vetë, pa qenë nevoja të më sillte

kaq telashe. Disa herë përplasa derën e dola jashtë, duke i thënë me të bërtitura se ajo nuk më kuptonte, se as unë vetë nuk e kuptoja si e kisha pranuar atë “marrëzi” për një fëmijë në moshën njëzetvjeçare, pa pasur një minimum kushtesh ekonomike. Bënim dashuri gjithnjë e më pak, o për shkak të lodhjes, o sepse ishim përherë të inatosur me njëri-tjetrin.

Fillova të bija në depresion, duke menduar se isha përdorur e manipuluar nga gruaja që dashuroja. Athina e kuptoi gjendjen time shpirtërore përherë e më të çuditshme dhe, në vend që të më ndihmonte, e ndau që ta përqendronte krejt energjinë e saj te Vioreli dhe te muzika. Shpëtimi im u bë puna. Ndonjëherë flisja me prindërit, po gjithmonë dëgjoja të njëjtën histori se “ajo bëri fëmijë që të të lidhte”.

Nga ana tjetër, përkushtimi i saj për fenë rritej nga dita në ditë. Shpejt kërkoi që të bëhej pagëzimi, me një emër që e kishte zgjedhur ajo vetë: Viorel, me prejardhje rumune. Ma merr mendja se, përveç disa pak emigrantëve, askush në Angli nuk quhej Viorel, por m’u duk original, dhe prapë mendova se po bënte një lidhje me një të kaluar që s’kishte arritur ta jetonte aspak: ditët në jetimoren e Sibiut.

Mundohesha t’i përshtatesha gjithçkaje, por ndieja se po e humbja Athinën për shkak të fëmijës. Grindjet u bënë më të shpeshta, ajo filloi të më kërcënonte se do të ikte nga shtëpia, pasi mendonte

se Vioreli po thithte “energjitë negative” të zënieve tona. Një natë, pas një tjetër kërcënimi, nga shtëpia ika unë, me mendje se do të kthehesha kur të qetësohesha paksa.

Fillova të ecja kuturu nëpër rrugët e Londrës, duke mallkuar jetën që kisha zgjedhur, fëmijën që kisha pranuar, gruan që dukej se tani nuk kishte as interesin më të vogël për mua. Hyra në barin më të parë, afër një stacioni metroje, dhe piva katër uiski. Kur u mbyll bari, në orën njëmbëdhjetë, shkova në një nga ato dyqanet që rrinë hapur tërë natën, mora prapë uiski, u ula në një stol të sheshit dhe vazhdova të pija. M’u afrua një grup të rinjsh që më kërkuan ta ndaja shishen me ta, nuk pranova dhe më goditën. Erdhi policia dhe përfundam të gjithë në komisarjat.

Më lëshuan pasi dëshmova. Sigurisht, nuk akuzova njeri; u thashë se kishte qenë një diskutim pa rëndësi, përndryshe do më ishte dashur të harxhoja muaj të tërë duke dalë nëpër gjyqe, si viktimë e një agresioni. Kur po bëhesha gati të dilja, isha aq i dehur sa rashë mbi tryezën e një inspektori të policisë. U nxeh, por në vend që të më arrestonte për mospërfillje ndaj autoriteteve, më nxori jashtë.

Aty ishte një nga ata që më kishin sulmuar. Më falënderoi që s’i kisha kallëzuar. Më tha se isha bërë shumë pis me baltë e me gjak dhe më sugjeroi të vishja rroba të tjera para se të kthehesha në shtëpi.

Në vend që të vazhdoja rrugën time, i kërkoja të më bënte një nder: të më dëgjonte, sepse kisha një nevojë të jashtëzakonshme për të folur.

Për një orë të tërë, dëgjoi në heshtje qaravitjet e mia. Në të vërtetë, nuk po flisja me të, po me veten time, një djalë që kishte gjithë jetën përpara, një karrierë që mund të ishte e shkëlqyer, një familje me lidhje të mjaftueshme për të hapur lehtë shumë dyer, por që tani ngjante si ndonjë lypës i lagjes Hampsted, i dehur, i lodhur, i trishtuar, pa para. Gjithçka për faj të një gruaje që as donte t'ia dinte për mua.

Si mbarova me historinë time, e pashë më të qartë gjendjen ku ndodhesha: një jetë që e kisha zgjedhur vetë, duke besuar se dashuria mund të shpëtojë gjithçka. Nuk është e vërtetë: ndonjëherë arrin të na çojë në greminë, e më e keqja është se në përgjithësi marrim me vete njerëzit që duam. Në këtë rast, unë po shkatërroja jo vetëm jetën time, po edhe të Athinës e të Viorelit.

Atë çast, ia përsërita edhe një herë vetes që isha burrë, e jo fëmijë i lindur në një djep floriri, prandaj duhej t'i përballoja me dinjitet krejt sfidat e jetës. U ktheva në shtëpi, Athina po flinte me fëmijën në krahë. Bëra banjë, dola edhe një herë që të hidhja rrobat në plehra dhe u shtriva për të fjetur, çuditërisht esëll.

Të nesërmen, i thashë se kërkoja divorcin. Më pyeti pse.

- Sepse të dua. Dua edhe Viorelin. Deri tani, e vetmja gjë që kam bërë është që ju fajësoja të dyve pse braktisa ëndrrën time për të qenë inxhinier. Po të kishim pritur pak, gjërat do të kishin qenë ndryshe, po ti i bëre planet vetëm për veten tënde, harrove të më përfshije dhe mua në to.

Athina nuk reagoi, si ta kishte pritur këtë gjë, ose sikur, pavetëdijsëm, ta kishte nxitur vetë një qëndrim të tillë.

Zemra më vajtonte, sepse prisja të më lutej që të rrija. Por ajo dukej e qetë, e pajtuar me fatin, e shqetësuar vetëm e vetëm që djali të mos e dëgjonte bisedën tonë. Pikërisht atëherë, pata sigurinë se kurrë nuk më kishte dashur, s'kisha qenë gjë tjetër veçse një vegël për të realizuar ëndrrën e saj të marrë për të pasur një fëmijë në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare.

I thashë se mund ta mbante shtëpinë me gjithë mobiljet, por kundërshtoi: do të shkonte për ca kohë te shtëpia e nënës së vet, do të kërkonte punë dhe do të merrte një apartament me qira. Më pyeti nëse mund ta ndihmoja ekonomikisht për Viorelin. Pranova në çast.

U ngrita, i dhashë një të puthur të gjatë dhe të fundit, ngula këmbë edhe një herë që të rrinte aty, tha përsëri se do të shkonte tek e ëma sapo të mblidhte gjërat e saj. Zura një hotel të lirë dhe çdo natë prisja të më telefononte e të më kërkonte që

të kthehesha, për të rifilluar një jetë të re: madje isha gati të vazhdoja të njëjtën jetë, po të ishte e nevojshme, sepse largimi nga ata më kishte bërë të kuptoja që nuk kishte asnjë njeri dhe asgjë në botë më të rëndësishme se gruaja dhe djali im.

Një javë më pas, më së fundi telefonoi. Po vetëm që të më thoshte se i kishte mbledhur sendet e saj dhe se nuk mendonte të kthehej. Nja dy javë më vonë, mësova se kishte marrë me qira një papafingo të vogël në rrugën Baset dhe se i duhej të ngjiste çdo ditë tre kate me djalin në krahë. Kaluan edhe nja dy muaj dhe më së fundi firmosëm letrat.

Familja ime e vërtetë po ikte përgjithmonë. E familja ku kisha lindur më priste me krahët hapur.

Mbas ndarjes sonë dhe vuajtjes së madhe që pasoi, e pyeta veten se mos në të vërtetë kishte qenë një vendim i gabuar, i papjekur, tipik për personat që kanë lexuar shumë histori dashurish gjatë adoleshencës dhe duan me çdo kusht të përsërisnin mitin e Romeos dhe Xhulietës. Kur dhimbja u qetësua - e për këtë ka vetëm një ilaç, koha - kuptova se jeta më kishte lejuar të njihja gruan e vetme që do të isha në gjendje të doja ndonjëherë. Çdo çast pranë saj kish vlejtur; pavarësisht nga të gjitha ato që ndodhën, do ta përsërisja çdo hap që pata bërë.

Por koha, përveç që m'i shëroi plagët, më tregoi edhe diçka të çuditshme: mund të duash më shumë se një person në jetë. U martova përsëri, ndihem

i lumtur me gruan time të re dhe nuk mund ta përfytyroj si do të ishte jeta pa të. Sidoqoftë, kjo nuk më detyron të mohoj gjithçka që jetova, gjithë duke u kujdesur për të mos i krahasuar dy përvojat; nuk mund ta masim dashurinë njëlloj siç masim rrugën apo lartësinë e një ndërtese.

Mbeti diçka shumë e rëndësishme nga lidhja ime me Athinën: një djalë, ëndrra e saj, që ma tha haptazi përpara se të vendosnim të martoheshim. Kam një tjetër fëmijë me gruan e dytë, tani jam i përgatitur mirë për të përpjetat dhe tatëpjetat e të qenit prind, jo si para dymbëdhjetë vjetësh.

Një herë, në një rastet që e pashë kur shkova të merrja Viorelin për ta kaluar fundjavën me mua, vendosa ta prekja këtë temë: e pyeta pse ishte treguar aq e qetë kur i thashë se doja të ndahesha.

- Sepse tërë jetën time jam mësuar të vuaj në heshtje, - m'u përgjigj.

Atëherë më përqafoi dhe derdhi krejt të gjitha lotët që do të kishte dashur t'i derdhte atë ditë.

Patër Xhankarlo Fontana

E pashë të hynte në meshën e së dielës, me fëmijën në krahë, si gjithmonë. I dija vështirësitë që po kalonin, po deri atë javë s'kishte qenë veçse një keqkuptim normal mes një çifti, për çka mendoja se herët a vonë do të zgjidhej, sepse të dy ishin njerëz që rrezatonin të Mirën përreth tyre.

Kishte një vit që nuk vinte mëngjeseve t'i binte kitarës dhe t'i thurte lavde Virgjëreshës; kujdesej për Viorelin, të cilin pata nderin ta pagëzoja, ndonëse, me sa di, nuk ka asnjë shenjtor me atë emër. Por vazhdonte të vinte në kishë çdo të diel dhe gjithmonë bisedonim në mbarim të meshës, pasi kishin ikur të gjithë. Më thoshte se isha miku i saj i vetëm; të dy merrnim pjesë në adhurimet hyjnore, por tani donte të ndante me mua nevojat tokësore.

E donte Lukasin më shumë se çdo burrë tjetër që kish njohur; ishte babai i fëmijës së saj, njeriu që kishte zgjedhur për të kaluar jetën, dikush që kishte hequr dorë nga të gjitha dhe kishte pasur

kurajën të krijonte familje. Kur filluan krizat, ajo përpiquej t'i linte të kuptonte atij se ishin kalimtare, se duhej t'i përkushtohej djalit, por jo se mendonte ta bënte një fëmijë të përkëdhelur; shpejt do ta linte të përballej vetë me sfidat e jetës. Pastaj do të bëhej prapë bashkëshortja dhe gruaja që ai kishte njohur në takimet e para, madje ndoshta me më shumë intensitet, sepse tani i dinte më mirë detyrimet dhe përgjegjësitë e zgjedhjes që kishte bërë. Megjithatë, Lukasi ndihej si i lënë mënjanë; ajo përpiquej me dëshpërim të ndahej mes të dyve, po vazhdimisht ndihej e detyruar të zgjidhte, e atëherë, pa kurrfarë ngurrimi, zgjidhte Viorelin.

Me ato pak njohuri që kam për psikologjinë, i thashë se nuk ishte hera e parë që dëgjoja histori si kjo, burrat në përgjithësi ndihen të mënjanuar në situata të tilla, por u kalon shpejt; nga besimtarët kisha dëgjuar edhe më parë për kësi problemesh. Në një nga këto biseda, Athina e pranoi se ndoshta ishte nxituar, se romantizmi për të qenë një nënë e re s'e kishte lënë t'i shihte qartë vështirësitë e vërteta që dalin pas lindjes së një fëmije. Por tani ishte vonë për t'u penduar.

Më pyeti nëse mund të flisja me Lukasin, që kurrë nuk vinte në kishë, o pse nuk besonte te Zoti, o pse parapëlqente t'i shfrytëzonte mëngjeset e së dielës për të ndenjur me të birin. Pranova, me kusht që ai të vinte me dëshirën e vet. Po kur Athina po

bëhej gati t'ia kërkonte këtë, ndodhi kriza e madhe, i shoqi iku nga shtëpia.

E këshillova të kishte durim, por ndihej tepër e prekur. E kishin braktisur një herë në fëmijëri, dhe gjithë urrejtjen që kishte për nënën e saj biologjike ia kaloi menjëherë Lukasit, ndonëse më vonë, me sa di unë, u bënë miq të mirë. Për Athinën, prishja e lidhjeve familjare ishte ndoshta mëkati më i madh që mund të kryesh.

Vazhdoi të vinte në kishë të dielave, po shpejt kthehej në shtëpi, sepse tani s'kishte me kë ta linte të birin dhe ai qante shumë gjatë ceremonisë, duke i shpërqendruar besimtarët e tjerë. Në një nga të paktat çaste që mundëm të flisnim, më tha të mos shqetësohesha; po punonte në një bankë, kishte marrë një apartament me qira dhe “babai” (nuk e përmendte më emrin e të shoqit) i përmbushte detyrimet e tij ekonomike.

Derisa sa mbërriti ajo e diel fatale.

E dija çfarë kishte ndodhur gjatë javës: ma kishte treguar një nga besimtarët. Kalova disa net në kërkim të ndonjë engjëlli që të më frymëzonte, të më shpjegonte nëse duhej të përmbushja detyrimet e mia ndaj kishës, apo detyrimet e mia ndaj njerëzve. Meqë engjëlli nuk u shfaq, kërkova takim me eprorin tim dhe ai më tha që Kisha mbijeton ngase gjithmonë ka qenë e ngurtë në dogmat e saj (po të kishim bërë përjashtime, do të kishim humbur qysh

në Mesjetë). E dija shumë mirë çfarë do të ndodhte, mendova t'i telefonoja Athinës, por nuk ma kishte dhënë numrin e ri të telefonit.

Atë mëngjes, m'u drodhën duart kur ngrita osten, duke shuguruar bukën. Thashë fjalët që më kishte përçarur tradita mijëvjeçare, duke përdorur fuqinë që apostujt kishin përçarur brez pas brez. Po atëherë mendimi im u drejtua nga ajo vajzë me fëmijën në krahë, njëfarë Shën Mërie, mrekullia e amësisë dhe e dashurisë shprehur në braktisjen dhe vetminë, që sapo u fut në rresht, siç bënte gjithmonë, dhe pak nga pak po afrohej për t'u kunguar.

Ma merr mendja se pjesa më e madhe e gjindjes përreth e dinin se çfarë po ndodhte. Të gjithë më shikonin, duke pritur reagimin tim. E pashë veten të rrethuar nga të drejtë, mëkatarë, hipokritë, priftërinj të Sanhedrinit, apostuj, dishepuj, njerëz të mirë e të këqij.

Athina ndaloi përpara meje dhe përsëriti veprimin e përhershëm: mbylli sytë dhe hapi gojën për të pritur trupin e Krishtit.

Trupi i Krishtit mbeti në duart e mia. Ajo hapi sytë, pa e kuptuar mirë se ç'po ndodhte.

- Flasim më vonë, - i pëshpërita.

Por ajo nuk lëvizti.

- Ka njerëz mbrapa, në radhë. Flasim më vonë.

- Çfarë po ndodh? - Të gjithë sa ishin afër e dëgjuan.

- Flasim më vonë.

- Pse nuk ma jep kungimin? A nuk e sheh se po më poshtëron përpara të gjithëve? Nuk mjaftojnë të gjitha sa kam kaluar?

- Athina, Kisha ua ndalon personave të ndarë të marrin sakramentin. Këtë javë ke firmosur letrat. Flasim më vonë, - ngula këmbë edhe një herë.

Meqë nuk lëvizte, i thashë atij që ndodhej prapa saj të dilte pak më tutje. Vazhdova me kungimin derisa e mori edhe besimtari i fundit. Dhe atëherë, para se të kthehesha te altari, dëgjova atë zë.

Nuk ishte më zëri i vajzës që këndonte për të adhuruar Virgjëreshën, që fliste për planet e saj, që emocionohet kur tregonte ato që kishte mësuar mbi jetën e shenjtorëve, që gati sa s'qante kur tregonte vështirësitë e martesës. Ishte zëri i një kafshe të plagosur, të poshtëruar, me shpirtin plot urrejtje.

- Mallkuar qoftë ky vend! - tha zëri. - Mallkuar qofshin ata që kurrë nuk i kanë dëgjuar fjalët e Krishtit dhe që e kanë shndërruar mesazhin e tij në një ngrehinë prej guri. Krishti tha: "Ejani tek unë, ju të trishtuar, se unë do t'ju ngushëlloj". Unë jam e trishtuar, e lënduar, por nuk më lini t'i afrohem Atij. Sot mësova se Kisha i ka ndryshuar këto fjalë. Ejani tek unë, ju që ndiqni rregullat tona, rrini mënjanë, ju të trishtuar!

Dëgjova një nga gratë e rreshtit të parë t'i thoshte që ta mbyllte gojën. Por unë doja të dëgjoja, kisha

nevojë të dëgjoja. U ktheva dhe qëndrova përballë saj, kokulur; ishte e vetmja gjë që mund të bëja.

- Betohem se kurrë më nuk do të shkel në ndonjë kishë. Përsëri më braktis një familje, por tani nuk bëhet fjalë për vështirësi ekonomike, as për papjekurinë e dikujt që martohet shumë herët. Mallkuar qofshin ata që ia mbyllin derën një nëne dhe birit të saj! Jeni njëlloj si ata që nuk i dhanë strehë Familjes së Shenjtë, njëlloj si ai që e mohoi Krishtin kur më shumë kishte nevojë për një mik!

U kthye dhe iku duke qarë, me fëmijën në krahë.

Mbarova shërbesën, dhashë bekimin e fundit dhe vajta drejt e te sakristia; atë të diel nuk do të kishte vëllazërim me besimtarët, as biseda të kota.

Atë të diel u gjenda përpara një dileme filozofike: kisha zgjedhur respektin ndaj institucionit dhe jo fjalët mbi të cilat bazohet institucioni.

Tani jam plak, Zoti mund të më marrë me vete në çdo çast. Mbeta besnik i fesë sime dhe mendoj se, pavarësisht nga gabimet që mund të ketë, po përpiqet sinqerisht për t'u ndrequr. Do t'i duhen dekada, ndoshta shekuj, porse një ditë e vetmja gjë që do të merret parasysh do të jetë dashuria, thënia e Krishtit: "Ejani tek unë, ju të trishtuar, se unë do t'ju ngushëlloj".

Ia kam kushtuar krejt jetën time priftërisë dhe asnjëherë nuk pendohem për vendimin që kam

marrë. Por në çaste si ai i asaj të diele, ndonëse nuk dyshova në fenë time, fillova të dyshoja te njerëzit.

Tani e di se çfarë ndodhi me Athinën dhe pyes veten: aty filloi gjithçka, apo ishte qysh më parë në shpirtin e saj? Më shkon mendja te shumë Athina e Lukas të botës që janë ndarë dhe që, nga ky shkak, nuk mund të marrin sakramentin e kungimit, nuk u mbetet gjë tjetër veçse të sodisin Krishtin që vuan i kryqëzuar e të dëgjojnë fjalët e tij (që jo gjithmonë janë në përputhje me ligjet e Vatikanit). Në shumë pak raste, këta njerëz largohen, pjesa më e madhe e tyre vazhdon të shkojë në meshën e të dielave, sepse u është bërë zakon, duke qenë të ndërgjegjshëm se e kanë të ndaluar mrekullinë e shndërrimit të bukës dhe verës në mish e gjak të Zotit.

Ma merr mendja se, kur doli nga kisha, Athina ndoshta u takua me Jezuin. Dhe, duke qarë, është hedhur në krahët e tij, e hutuar, duke i kërkuar t'i shpjegonte pse e detyronin të mbetej përjashta vetëm për faj të një letre të firmosur, diçka pa pikë rëndësie nga pikëpamja shpirtërore, dhe që shërbente vetëm për burokracinë e për deklarimin e të ardhurave.

Duke e vështruar Athinën, Jezui ndoshta i është përgjigjur:

- Pa shih, bija ime, edhe unë jam jashtë. U bë shumë kohë që nuk më lënë të hyj atje brenda.

**Pavel Podbieslki, 57 vjeç,
pronari i apartamentit**

Athina dhe unë kishim një gjë të përbashkët: të dy ishim të mërguar luftime, erdhëm në Angli që fëmijë, ndonëse ikja ime nga Polonia ka ndodhur më shumë se pesëdhjetë vjet më parë. Të dy e dinim që, në mërgim, edhe pse gjithmonë ka një ndryshim gjeografik, zakonet ruhen: komunitetet mblidhen përsëri, gjuha dhe besimi mbeten të gjalla, njerëzit priren të mbrojnë njëri-tjetrin në një mjedis që do të jetë i huaj për ta përgjithmonë.

Njëllor siç ndodh që ruhen zakonet, ndodh që dëshira për t'u kthyer fillon e zhduket pak nga pak. Kemi nevojë që të mbetet e gjallë në zemrat tona një shpresë me të cilën na e ka ënda të gënjejme veten, por që kurrë nuk do të bëhet realitet; unë nuk do të kthehesha më për të jetuar në Çestohovë, ajo dhe familja e saj kurrë nuk do të ktheheshin në Bejrut.

Ishte ky lloj solidariteti që më bëri t'ia lëshoja me qira apartamentin e katit të tretë të shtëpisë time në

rrugën Baset, përndryshe do të kisha parapëlqyer qiraxhinj pa fëmijë. E kisha bërë këtë gabim dikur dhe gjithmonë më ndodhte e njëjta gjë: nga njëra anë, ankohesha për zhurmën që bënin ata gjatë ditës, nga ana tjetër, ata ankoheshin për zhurmën që bëja unë gjatë natës. Në të dyja rastet, problemi qëndronte në gjëra të shenjta - e qara dhe muzika - por, ngaqë i përkisnin dy botëve krejt të ndryshme, ishte e vështirë që t'i hapnim rrugë njëri-tjetrit.

E paralajmërova, por nuk më dëgjoji, më tha të mos shqetësohesha për djalnin e saj, sepse e kalonte ditën te shtëpia e gjyshes. Ndërsa apartamenti kishte të mirën se ishte afër punës së saj, një bankë aty rrotull.

Me gjithë paralajmërimet e mia, megjithëse kisha e kundërshtuar fort në fillim, tetë ditë më vonë ra zilja e derës. Ishte ajo, me fëmijën në krahë:

- Im bir nuk mund të flejë. Të paktën vetëm për sot, a mund ta ulësh zërin e muzikës?...

Të gjithë sa ishin aty po e shihnin.

- Çfarë ka?

Fëmija që kishte në krahë pushoi menjëherë së qari, si të çuditej po aq sa e ëma kur pa atë grup njerëzish që papritur nuk po vallëzonte më.

Shtypa butonin për të ndalur kasetofonin, ia bëra me dorë të hynte brenda dhe e ndeza aparatit sërishmi, për të mos prishur ritualin. Athina u ul në një cep të sallës duke përkundur të birin, që e

zuri gjumi shpejt, me gjithë zhurmën e daulles e të veglave frymore.

E ndoqi krejt ceremoninë, u largua pasi ikën edhe të tjerët dhe - sikurse ma mori mendja - i ra ziles së derës të nesërmen në mëngjes, para se të shkonte në punë.

- S'ke pse më shpjegon atë që pashë: njerëz që vallëzonin symbyllur, e di se çfarë do të thotë kjo, sepse shpesh bëj të njëjtën gjë; janë të vetmet çaste paqeje dhe qetësie që kam në jetë. Para se të bëhesha nënë, shkoja nëpër diskoteka me tim shoq e me miq tanët; edhe atje, shihja njerëz që vallëzonin symbyllur, disa thjesht për t'u bërë përshtypje të tjerëve, disa si të viheshin në lëvizje nga një forcë madhore, më e fuqishme. Dhe, qëkurse mbaj mend, vallëzoj për t'u lidhur me diçka më të fortë e më të fuqishme se unë. Po doja të dija çfarë muzike është kjo.

- Çfarë do të bësh këtë të diel?

- Asgjë të veçantë. Do të shëtis me Viorelin në Rexhent Park, të thithim pak ajër të pastër. Kam kohë për planet e mia: tani për tani kam vendosur të eci sipas planeve të tim biri.

- Do vij me ty.

Të dy ditët para shëtites tonë, Athina mori pjesë në ritual. Djali flinte sa kalonin disa minuta, ndërsa ajo vetëm vështronte pa thënë asgjë lëvizjen përreth saj. Ndonëse qëndronte e palëvizur në kolltuk, isha i sigurt se shpirti i saj vallëzonte.